



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, 5, 13 par. 1 dhe 14 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2013 për Caqet e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë;
- Nenin 4 paragrafi 1, 2 dhe 3, nenin 5 par. 2, nenin 6 par. 2, nenin 8, nenin 9 par. 1 dhe nenin 11 të Rregullës për Skemën Mbështetëse;
- Vendimin nr. V-673-2014 dt. 23 dhjetor 2014 për përcaktimin e Tarifës Nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë;
- Aplikacionin/Kërkesën për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, në Lumin Erenik, HC Jasiq Erenik me kapacitet të instaluar prej 5 MW, Komuna e Junikut, Republika e Kosovës, të datës 19.06.2015 të shoqërisë "Triangle General Contractors – INC" Branch Kosova, me adresë: rruga "Fusha e Pejës"p.n. – Pejë , Republika e Kosovës, dhe
- Aplikacionin për Pranin në Skemën Mbështetëse,

në seancën e mbajtur me datë 28 janar 2016 nxori këtë:

V E N D I M

Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar

- I. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) konstaton se shoqëria shoqërisë "Triangle General Contractors – INC" Branch Kosova, ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, në Lumin Erenik, HC Jasiq Erenik me kapacitet të instaluar prej 5 MW, Komuna e Junikut, Republika e Kosovës.
- II. Aplikuesit shoqërisë "Triangle General Contractors – INC" Branch Kosova, do t'i lëshohet AUTORIZIMI për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga uji, pas përmbushjes së kërkesave që dalin nga Nenet 14 dhe 15 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe kërkesave tjera të legjislacionit tjetër të aplikueshëm lidhur me ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese.
- III. Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar nuk i jep të drejtë bartësit që të fillojë ndërtimin e stabilimentit të ri gjenerues para se t'i plotësojë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në pikën II. të këtij Vendimi.
- IV. Njoftimi mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar përcakton disponueshmërinë e caqeve si dhe pranimin e aplikuesit në skemën mbështetëse dhe garantimin automatik të tarifës nxitëse.



- V. Njoftimi mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar përcakton se aplikuesit i garantohet lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë elektrike me Furnizuesit publik në kohëzgjatje 10 (dhjetë) vjeçare, e cila do të lidhet së paku (30) ditësh para datës së fillimit të operimit gjenerues.
- VI. Vendimi mbi njoftimin për autorizimin preliminar lëshohet për periudhë një (1) vjeçare, brenda së cilës periudhë aplikuesi obligohet që ti plotësoi kërkesat sipas pikës II të diapozitivit të këtij Vendimi, dhe me shkrim të kërkojë lëshimin e Autorizimit për ndërtim të stabilimentit të ri gjenerues nga Uji.


Arsyetim


- ZRRE me datë 19.06.2015 nga shoqëria shoqërisë **“Triangle General Contractors – INC” Branch Kosova**, ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, në Lumin Erenik, HC Jasiq Erenik me kapacitet të instaluar prej **5 MW**, Komuna e Junikut, Republika e Kosovës.
 - ZRRE me datë 19.06.2015 nga shoqëria shoqërisë **“Triangle General Contractors – INC” Branch Kosova** ka pranuar aplikacioni për pranimit në skemën mbështetëse.
 - ZRRE, pas vlerësimit të kërkesave dhe dëshmive relevante të bashkangjitura aplikacionit, pranimit të dëshmive tjera plotësuese, të kërkuara nga ZRRE, dhe vlerësimit të përmbajtjes së aplikacionit për pranimit në skemën mbështetëse, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- VII. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Enver Halimi, kryesues


Krenar Bujupi, anëtar


Arsim Janova, anëtar


Qemajl Mustafa, anëtar


Besim Sejfiqaj, anëtar